



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Primijeno/Protuto Received/Delivery	28. 01	2021	1 viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org./Unit	Nr Prot Bi Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHP/WHM	344/2021		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 423/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.423/2020 të datës 17.12.2020 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rr. "Fehmi Agani", Nr.60/A, Komuna e Gjakovës, kundër Vendimit me numër 112/01-26417, të datës 10.11.2020, të Kryetarit të Komunës së Gjakovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 25.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet Poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.423/2020 të datës 17.12.2020, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Gjakovës në pozitën "Bashkëpunëtor Profesional", përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar me datë 17.02.2020, me Nr.Prot:3185/2020 dhe numër regjistrimi A.nr.423/2020, kundër Vendimit Nr.112/01-26417, të datës 10.11.2020, të Kryetarit të Komunës së Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 21.12.2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Komuna e Gjakovës. Ndërsa, Këshilli me datën 05.01.2021 përmes e-mailit ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Gjakovës së bashku me shkresat tjera të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe vendosje meritorë të çështjes, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 17.12.2020 me Nr.Prot:3185/2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës: Vendim me numër Nr.112/01-26417 i datës 10.11.2020, i lëshuar nga Kryetari i

Komunës së Gjakovës; Vendim me numër 14-530/1153-2020, i datës 13.11.2020, i lëshuar nga Inspektori sanitar i Komunës së Gjakovës; Akt Emmërimin e datës 12.03.2012 me numër Nr.112-143/15 i ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 15.01.2021 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Menaxherin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 21.12.2020, Përgjigja në ankesë e datës 05.01.2021, përmes e-mailit zyrtar (adresës elektronike), nga Menaxheri i burimeve njerëzore i Komunës së Gjakovës me shkresat e bashkangjitura, emali i datës 12.11.2020.

Kolegji pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit është e pa lejuar, *sepse:*

Ankuesi në ankesën e tij të parashtruar në Këshill pretendon se nuk është informuar formalisht me Vendimin Nr.112/01-264117 të datës 10.11.2020, dhe se ky vendim është nxjerrë në kohën kur ankuesi ka qenë në vet izolim për shkak të infektimit me COVICD-19. Me tutje deklaron se vendimi përmban shkelje të dispozitave procedurale të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike përkatësisht konstatimet dhe përfundimet në dispozitiv nuk kanë mbështetje në prova por në hamendësime dhe jo profesionalizëm, si dhe mos aplikim të së drejtës materiale, duke kërkuar nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloh vendimin e Kryetarit të Komunës të datës 10.11.2020.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin e ankesës ka gjetur se: Ankuesi është i sistemuar në pozitën e Bashkëpunëtorit Profesional, në Drejtorinë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në Komunën e Gjakovës. Kryetari i Komunës së Gjakovës me Vendimin numër Nr.112/01-26417, të datës 10.11.2020, ka themeluar Komisionin për Verifikimin dhe Lirimin e Pronave Komunale-dyqaneve, duke emëruar ankuesin si kryesues të këtij Komisioni. Vendimi i është dërguar ankuesit si dhe anëtareve tjerë të Komisionit me datë 12.11.2020. Bazuar në njoftimin e datës 15.01.2021 të Inspektoratit Sanitar të Gjakovës me nr. Reference 14-530-01-1274, vërtetohet se ankuesi ka qenë në vet izolim nga data 09.11.2020 ku dhe i është lëshuar vendimi Nr.14-530/1153/2020 i datës 13.11.2020, ndërsa me datë 23.11.2020 me vendimin Nr. 14-530/1153/1132-2020 është shfuqizuar Vendimi Nr. 14-530/1153/2020 i datës 13.11.2020.

Në vështrim të dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.

Andaj, duke u bazuar në faktin se Vendimi Nr.112/01-26417, i datës 10.11.2020, i Kryetarit të Komunës së Gjakovës për themelimin e Komisionit për Verifikimin dhe Lirimin e Pronave Komunale-dyqaneve, i është dorëzuar ankuesit me datë 12.11.2020, Kolegji konstaton se ushtrimi i ankesës kundër këtij vendimi me datë 17.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Pas konstatimit se ankesa ashtë e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nen paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji nuk u lëshua në shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Andaj , bazuar në këto rrethana Kolegji për Shqyrtim dhe Vendosje të ankesës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.423/2020, datë 17.12.2021

Ardita Përçuku-SHYTI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI



Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës ;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

